



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 850 Prot.

Tiranë më 26.03.2024

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 26.03.2024

MBI

RESPEKTIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE NË KUADËR TË MBROJTJES
SË TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E NDËRMJETËSIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të Kontrolluesve në sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme (*real estate*), në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka realizuar hetime administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese nga Kontrolluesit në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim verifikimin e respektimit të parimeve dhe kritereve ligjore të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe me fokus të veçantë masat teknike dhe organizative për përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) të parashikuar në nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit gjatë veprimtarisë së tij monitoruese mbi zbatimin e detyrimeve të Ligjit nga Kontrolluesit, ka vërejtur një shqetësim në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit, sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të subjekteve të të

dhënave, nga Kontrolluesit në sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme.

Ky shqetësim është konstatuar nga burime të ndryshme, por edhe me vetë indicie të institucionit lidhur mbi proceset përpunuese të Kontrolluesve që operojnë në këtë sektor, kjo për shkak të rritjes së veprimtarisë së tyre dhe njëkohësisht të sasisë së të dhënave personale që përpunojnë.

Bazuar në pikën 12, të nenit 3 të Ligjit, *“Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.*

Gjithashtu, referuar pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, *“Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.*

Në këtë kuptim, si dhe në zbatim të Ligjit, ndërmjetësuesit e pasurive të paluajtshme janë Kontrollues, pavarësisht formës së organizimit të aktivitetit të tyre si “person juridik” apo “person fizik”.

Monitorimi i proceseve përpunuese të të dhënave personale të Kontrolluesve në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, nisur nga rëndësia e këtyre të dhënave, por edhe nga fakti se ka një numër shumë të lartë Kontrolluesish që operojnë në këtë fushë, të cilët përpunojnë të dhëna personale në sasi të mëdha, në përmbushje të detyrimeve ligjore sipas përcaktimeve të legjislacionit specifik, ka sjellë dhe nevojën për një vëmendje të shtuar nga ana e Zyrës së Komisionerit, në kuadër të garantimit të përpunimit të ligjshëm, sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit dhe respektimin e parimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Ndërkohë, krahas dispozitave të sipërpërmendura të Ligjit, hetimet administrative janë bazuar edhe në parashikimet e akteve nënligjore të tjera detyruese të nxjerra nga Zyra e Komisionerit në zbatim të Ligjit dhe më specifikisht të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr.*

47”) dhe si të tillë, kanë detyrimin që të plotësojnë të gjithë parashikimet që burojnë nga baza ligjore e sipërcituar për sa i përket të dhënave personale që përpunojnë.

Referuar pikës 2, të nenit 3, të Ligjit nr. 9/2022 “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”, citohet se: “Ndërmjetës i pasurive të paluajtshme” është personi fizik i certifikuar nga ministria përgjegjëse për drejtësinë për të ndërmjetësuar përfundimin e një marrëveshjeje për realizimin e veprimit juridik të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme ose të të drejtave reale mbi to”. Gjithashtu, bazuar në pikën 1 të nenit 7, të po këtij ligji rezulton se, “Ministri është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili u jep certifikatën individuale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme personave fizik që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si ndërmjetës të pasurive të paluajtshme në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj”.

Profesioni i ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme mund të ushtrohet vetëm nga personi që është certifikuar për kryerjen e kësaj veprimtarie dhe është i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9/2022 “Për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”.

Për sa u përshtrua më lart, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë iniciativën e disa hetimeve administrative pranë disa subjekteve të ndryshme, në cilësinë e Kontrolluesve, që operojnë në sektorin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, të cilët kanë si objekt të veprimtarisë krijimin, zhvillimin e zyrave të ndërmjetësimit për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet zgjerimit të rrjetit “Franchise” dhe shitjes së kontratave *franchising*.

Në vijim do të listohen disa nga problematikat e konstatuara gjatë hetimeve administrative të ushtruara pranë këtyre Kontrolluesve:

1. Në kuadër të veprimtarisë që kryejnë, Kontrolluesit përpunojnë të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punonjës”, “agjentë”, “vizitorë”, “kandidatë për punë”, etj., në mënyrë manuale dhe elektronike.

Rezulton se, në shumë raste, Kontrolluesit nuk kanë parashikuar afate për ruajtjen e të dhënave personale që përpunohen (*psh., të agjentëve dhe klientëve*) në tejkalim të qëllimit të përpunimit, në kundërshtim me një nga parimet tek i cili bazohet mbrojtja e të dhënave personale, të parashikuar në germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesit duhet të parashikojnë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin

për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

2. Konstatohet se, në faqen zyrtare të Kontrolluesve, si dhe në platformat “Facebook” dhe “Instagram”, të administruar nga ana e tyre, ndër të tjera, gjenden të publikuara të dhënat e agjenteve si: “emër”, “mbiemër”, “nr. telefoni”, “fotografia e agjentit”, etj. Kontrolluesit nuk kanë mundur të dokumentojnë se kanë marrë pëlqimin e subjekteve të të dhënave “agjentë të rrjetit Franchise”, për publikimin e të dhënave të tyre, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i të dhënave personale konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave legjitimohet, vetëm, nëse plotësohet minimalisht njëri prej kriterëve ligjore për përpunim, si për shembull, në këtë rast, “pëlqimi” i subjektit të të dhënave.

“Pëlqimi”, është një nga 6 principet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, i parashikuar në pikën 1, të nenit 6 të Ligjit. Në rastin kur Kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash, ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit. Nëse është marrë në përputhje me Ligjin, “pëlqimi” është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave, kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo.

3. Rezulton se, Kontrolluesit kanë publikuar në faqen zyrtare “Politikat e Privatësisë”, megjithatë i referohen modelit standard të politikave të privatësisë të “Franchise” dhënësit (kompanisë mëmë), si dhe subjektet e të dhënave (klientë, vizitorë, punonjës, agjentë, etj.) nuk informohen në gjuhën shqipe për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave të tij, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, në kontratën “tip” të ndërmjetësimit ekskluziv për shitje, për ndërmjetësim të pasurive të paluajtshme dhe formularit të intervistës me Klientin Shitës rezulton se, nuk është parashikuar një rubrikë e veçantë në të cilën të jetë

parashikuar informimi i subjektit të të dhënave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

Gjithashtu, çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të tij, ka detyrimin që të publikojë *“Politikat e Privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me Kontrolluesin realizohet përmes faqes online të internetit. Në këtë kuadër, publikimi i *“Politikave të Privatësisë”* në faqen zyrtare të Kontrolluesit, përmbush qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe.

4. Në kontratat e shërbimit, që aplikojnë Kontrolluesit me palë të treta, rezulton se në përmbajtje të tyre nuk janë reflektuar detyrimet për përcaktimin e rregullave në lidhje me marrëdhënien mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, me qëllim ofrimin e garancive të plota për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga pala, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Referuar Ligjit, *“Përpunues”* është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit (pika 7, e nenit 3 të Ligjit).

Roli që kanë palët është thelbësor për të bërë rregullimet e duhura në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu, është e mundshme që franshiz marrësi të kualifikohet si përpunues i të dhënave kur në cilësinë e marrësit të ekskluzivitetit (franshiz marrës) dhe përpunon të dhënat personale, në emër të franshizdhënësit, ose kur franshizdhënësi ofron dhe menaxhon një sistem që franshiz marrësit përdorin për të përpunuar të dhënat personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit duhet të përfshihen në marrëveshjet/kontratat dhe/ose aneks kontratat e nënshkruara mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing/shërbimi*) që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Kontrata midis palëve duhet të parashikojë masat që duhet të marrë Përpunuesi, për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre në çdo hallkë të këtij përpunimi.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se, disa Kontrollues nuk kanë përmbushur detyrimin për “*Njoftim*” në zbatim të nenit 21 të Ligjit, si dhe disa të tjerë, nuk kanë kryer përditësimin e njoftimit për ndryshim të gjendjes së Njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “*Formularit të Njoftimit*” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen Kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji. Mospërmbushja e detyrimit për “*Njoftim*” përbën shkelje të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

6. Rezulton se, edhe në Kontrolluesit që disponojnë Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” konstatohet se, i referohen modelit “*tip*” të publikuar në faqen e internetit të Zyrës së Komisionerit. Megjithatë, nga shqyrtimi i tyre konstatohet se, përmbajtja e tyre është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, kategorive të subjekteve të të dhënave në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesit nuk kanë ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, konstatohet mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesit duhet të marrin masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit.

Sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, është detyrim i subjektit përpunues të të dhënave personale që të siguroj trajnim profesional operatorëve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për detyrimet e Ligjit.

Për shkak të cilësisë si subjekte përpunuese të mëdha, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtrojnë, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesit janë të detyruar të krijojnë, mirëmbajnë dhe administrojnë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5, të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*).

Zyra e Komisionerit thekson se, nevojitet një angazhim serioz i Kontrolluesve dhe Përpunuesve në sektorin e administrimit dhe ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, në lidhje me marrjen e masave tekniko-organizative për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimet nr. 19, 47, 48 të Komisionerit.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesve të këtij sektori është shumë i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesit, të kenë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesit, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit të marrin masa për shkatërrimin e të dhënave të ruajtura/mbledhura në tejkallim të qëllimit të përpunimit për të cilat janë mbledhur, si dhe të garantojnë pëlqimin e subjekteve të të dhënave “Agjentë” për publikimin e të dhënave të tyre në faqet e internetit;
3. Kontrolluesit, të marrin masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
4. Kontrolluesit, të marrin masa për informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
5. Kontrolluesit, të marrin masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e tyre, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
6. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të plotësohet detyrimi për njoftim nga Kontrolluesit, të cilët nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë, si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë;
7. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojnë Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
8. Kontrolluesit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses në të dhëna personale dhe krijimin,

mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

9. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së përgjithshme të ndërmjetësve të pasurive të paluajtshme, duhet të marrë masa për të adresuar drejt të gjithë Kontrolluesve dhe Përpunuesve të këtij sektori, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, brenda afatit kohor 90 (nëntëdhjetë) ditor, duke filluar nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;
10. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi